



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 337/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Joniad Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.08.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” shpk në procedurën e prokurimit “E Hapur”, me nr. REF-51263-02-21-2020, me objekt: “Blerje ushqime në lote: Loti III – Objekti “Blerje bukë (thekre dhe integrale)”, me fond limit 4.509.600 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 22.05.2020, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

**Ankimues:** “Kadra” shpk.  
Adresa: Rruga “Nënë Treza”, Laknas, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës.  
Adresa; Sheshi “Liria”, Durrës.

**Subjekte të interesuar:** 4 S” shpk.  
Adresa: Lagjia “Xhevat Nepravishta”, Rruga “Çajupi”, pranë shkollës “Liri Kazazi”, Lushnje.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1, të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.02.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*E Hapur*”, me nr. REF-51263-02-21-2020, me objekt: “*Blerje ushqime në lote: Loti III – Objekti “Blerje bukë (thekre dhe integrale)*”, me fond limit 4.509.600 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 22.05.2020, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 22.05.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 03.06.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ <i>Gerti 1987</i> ” shpk	pa ofertë	skualifikuar
2. “ <i>4 S</i> ” shpk	2.745.000 lekë	kualifikuar
3. “ <i>Kadra</i> ” shpk	2.790.220 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 03.06.2020, operatori ekonomik "Kadra" shpk është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe kualifikimin e tij.

II.5. Operatori ekonomik "Kadra" shpk, në datën 08.06.2020 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së shoqërisë "4 S" shpk në procedurën e prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...]

Në datë 03.06.2020 autoriteti kontraktor Bashka Durrës publikoi në sistemin e Agjencisë së Prokurimeve Publike njoftimin e klasifikimit, ku oferta e shoqërisë "Kadra" shpk dhe shoqërisë "4 S" shpk janë kualifikuar.

Në nenin 2, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar përcaktohen parimet e përzgjedhjes së fituesit, citojmë: "Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve."

Sa më sipër, në dijeninë e shoqërisë "Kadra" shpk operatori ekonomik "4 S" shpk muk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në këtë procedurë dhe konkretisht pikën 2.3.c të kapacitetit teknik: "Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatën ISO 22000:2018 (ose ekuivalentet me to). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.).

Bazuar në rekomandimin mbi hartimin e kërkesave të cilësisë mes Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të datës 20.03.2018 me Nr.3330 prot, konkretisht pika 2 e këtij rekomandimi është përcaktuar që: "Autoriteti kontraktor për të vërtetuar se mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë mund t'u kërkojmë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."

Sa më lart cituam operatori ekonomik "4 S" shpk nuk ka përmbushur këtë kërkesë sipas rekomandimit të APP-së dhe ka paraqitur certifikatë ISO 22000:2018, e cila është e paakredituar nga organet kompetente sipas rekomandimit të sipërcituar dhe autoriteti kontraktor ka kualifikuar këtë operator në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, por edhe në kundërshtim të rekomandimit të sipërpërmendur si dhe bashkëlidhur kësaj ankese.

Kërkojmë nga autoriteti kontraktor të verifikojë dokumentacionin e operatorit ekonomik "4 S" shpk për plotësimin e pikës 2.3.C të kapacitetit teknik dhe të korrigjojë shkeljen e bërë gjatë vlerësimit.

Në nenin 2, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar përcaktohen parimet e përzgjedhjes së fituesit, citojmë: "Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.”.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Përsa më sipër argumentuam në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.20006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe dokumentave të tenderit kërkojmë:

1. Rishikimin e dokumentit të përmendur më lart për operatorin ekonomik “4 S” shpk.
2. Rivlerësimin e ofertave dhe skualifikimin e operatorin ekonomik “4 S” shpk..

II.5. Me anë të shkresës nr.3472/8 prot., datë 11.06.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë me pretendimet si më poshtë:

Në përgjigje të ankesës tuaj, protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.3472/1 prot., datë 08.06.2020 për kontratën me objekt: “Blerje ushqimesh në lote, Loll i III, Blerje buke (thekre dhe integrate)” për Bashkinë Durrës, bazuuar në nenin 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ju vëmë në dijeni se ankesa juaj është refuzuar me arsyetimin si më poshtë:

Lidhur me pretendimin tuaj se vendimi për kualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” shpk është i padrejtë, argumentuar se: Operatori ekonomik “4 S” shpk nuk ka përmbushur kriterin e kërkuar në dokumentat e tenderit lidhur me Çertifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000 : 2018, duke pretenduar se çertifikata e paraqitur prej tij është e paakredituar nga organet kompetente, sipas rekomandimit me nr.3330 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, nuk qëndron.

Për të vërtetuar pretendimet tuaja, Komisioni i Shqyrtimit të ankesës pas ballafaqimit me dokumentacionin e ndodhur në sistemin elektronik të APP komunikoi nëpërmjet postës elektronike me “AQSCERT” shpk, i cili ka lëshur Çertifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, EN-ISO 22000:2018 në emër të operatorit ekonomik “4 S” shpk.

Në përgjigje të saj, AQSCERT Albania, konfirmoi nëpërmjet Çertifikatës së Akreditimit me numër rregjistri CS 008 se është akredituar si organizëm certifikues sistemi menaxhimi në përpithje me SSH ISO/IEC 17021-1:2015 “Vlerësimi i Konformitetit – Kërkesa për organizmat që kryejnë vlerësimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit.

*Referuar sa më sipër jemi të mendimit se ankesa juaj është e padrejtë dhe e pabazuar në ligj dhe në prova.*

*Theksojmë se KVO ka klasifikuar në vend të parë për akordimin e kontratës ofertuesin “4 S” shpk me vlerë të ofertës 2.745.000 lekë.*

*KVO referuar nenit 55, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ka klasifikuar në vendin e parë ofertuesin me ofertën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë, në respektim të kriterit ligjor primar të përcaktuar qartë në ligjin e prokurimit publik (oferta ekonomikisht më e favorshme), operatorin ekonomik “4 S” shpk me vlerë të ofertës 2.745.000 lekë, i cili sipas vlerësimit të KVO përmbush të gjithë kriteret e kërkuara në dokumentat e tenderit.*

*Komisioni i shqyrtimit të ankesës gjykon se vendimi i KVO-së është i drejtë dhe i mbështetur në aktet ligjore në fuqi dhe konform kritereve të kërkuara në dokumentat e tenderit.*

*Përsa më sipër ju sqarojmë se ankesa juaj refuzohet.*

II.6. Në datën 17.06.2020 operatori ekonomik “Kadra” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 6992/1 prot., datë 03.07.2020, protokolluar me tonën në datën 17.08.2020 me objekt “Dërgim Informacioni ” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kadra” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “4 S” shpk, me arsyetimin se: “Sa më sipër, në dijeninë e shoqërisë “Kadra” shpk, operatori ekonomik “4 S” shpk nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në këtë procedurë dhe konkretisht pikën 2.3.c të kapacitetit teknik: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Çertifikatën ISO 22000:2018 (ose ekuivalentet me to). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.).

*Bazuar në rekomandimin mbi hartimin e kërkesave të cilësisë mes Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të datës 20.03.2018 me Nr.3330 prot, konkretisht pika 2 e këtij rekomandimi është përcaktuar që: “Autoriteti kontraktor për të vërtetuar se mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë mund t’u kërkojmë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i*

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”. Sa më lart cituam operatori ekonomik “4 S” shpk nuk ka përmbushur këtë kërkesë sipas rekomandimit të APP-së dhe ka paraqitur certifikatë ISO 22000:2018, e cila është e paakredituar nga organet kompetente sipas rekomandimit të sipërcituar dhe autoriteti kontraktor ka kualifikuar këtë operator në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, por edhe në kundërshtim të rekomandimit të sipërpërmendur si dhe bashkëlidhur kësaj ankese.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta për Kualifikim” Loti III – “Blerje bukë (thekre dhe integrale)” pika 2.3.c të dokumentave të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“c. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë Çertifikatë ISO 22000:2018, (ose ekuivalente me to) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).”.

III.3.2. Nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë (SPE), konstatohet se operatori ekonomik ankimues “4 S” shpk për plotësimin e kriterit të sipërpërmendur ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Certifikatë ISO 22000:2018 me nr.AQS/SA/39982019, për objektin: “Tregtim i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore. Tregëtim i nënprodukteve të brumit (bukë, ëmbëlsira ... etj). Furnizimi me produkte ushqimore për operatorët ekonomikë publikë dhe privatë (spitale, shkolla kopshte, çerdhe, ... etj). Shërbime cateringu për operatorët ekonomikë publikë dhe privatë. Tregëtimi me shumicë dhe pakicë i paisjeve dhe enëve të kuzhinës”, lëshuar nga organizimi certifikues “AQScert Albania” shpk, për operatorin ekonomik “4 S” shpk, në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.4. Në nenin 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të

*lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” 1. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”*

III.3.5. Për verifikimin e pretendimeve të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik nisur nga fakti se certifikata Certifikata ISO 22000:2018 me nr.AQS/SA/39982019 është lëshuar nga organizmi certifikues shqiptar “AQScert Albania” shpk, si dhe bështetur në parashikimet e nenit 6, të Ligjit nr.116/2014, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me shkresën nr.588/4 prot, datë 10.08.2020 i kërkoi Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit informacion lidhur me faktin nëse Organizmi i Vlerësimit të Konformiteti AQScert është i akredituar për të certifikuar subjekte të ndryshme në standartin EN-ISO 22000:2018, në aktivitetin e prodhimit dhe /ose tregtimit të bukës.

Pas kërkesës për informacion, Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit si i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit, kjo e fundit në përgjigjen e sjellë, me shkresën nr.226/1 prot, datë 18.08.2020, protokolluar tek ne më datë 24.08.2020, sqaron se: “Në përgjigje të shkresës suaj nr. 588/4 prot., datë 10.08.2020, lidhur me informacionin për Organizmin e Vlerësimit të Konformitetit AQScert, ju informojmë që ky organizëm është akredituar nga DPA për standartin EN-ISO 22000:2018, deri më datë 28.03.2022. Por subjekti është i akredituar për aktivitetin e tregtimit dhe jot ë prodhimit të bukës.”.

III.3.5. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k është paraqitur Certifikatën ISO 22000:2018 me nr.AQS/SA/39982019, për objektin: “Tregtim i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshgazore. Tregëtim i nënprodukteve të brumit (bukë, ëmbëlsira ... etj). Furnizimi me produkte ushqimore për operatorët ekonomikë publikë dhe privatë (spitale, shkolla, kopshte, çerdhe, ... etj). Shërbime katering për operatorët ekonomikë publikë dhe privatë. Tregëtimi me shumicë dhe pakicë i paisjeve dhe enëve të kuzhinës”,, nëpërmjet të cilës kjo shoqëri deklaron se është e certifikuar për tregtimin e nënprodukteve të brumit, ku një nga këto nënprodukte është edhe buka.

Nisur nga përgjigja e sipërpërmendur Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se Certifikata ISO 22000:2018 me nr.AQS/SA/39982019 është e lëshuar nga një organizëm i akredituar nga Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit dhe për më tepër është i akredituar për aktivitetin e tregtimit të bukës.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se objekti i veprimtarisë së Certifikatës ISO 22000:2018 me nr.AQS/SA/39982019 përputhet me objektin e prokurimit, pasi referuar kërkesës së përcaktuar në shtojcën 9, pika 2.3.d, të dokumentave të tenderit të modifikuar, autoritetit kontraktor ka kërkuar që ofertuesit të jenë të pajisur me Licensë të lëshuar nga QKL-ja me Kodin II.1.A, ku objekti i veprimtarisë së kësaj licensë referuar Aneksit 1, Fusha II, pika 2/a të VKM nr.385, datë 26.05.2020 “Për licencat dhe lejet që trajtorhen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, përcaktohet se: “2. Kjo licensë ndahet në këto nënkategori: a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A.” është ose prodhim ose shpërndarje, gjë që në rastin konkret përputhet me certifikatën e

sipërpërmendur, pasi sikurse e konfirmon dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kjo certifikatë është e akredituar për aktivitetin e tregtimit të bukës.

Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “4 S” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur, e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9 pika 2.3.c, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi vërteton se disponon Çertifikatën ISO 22000:2018, e cila është e lëshuar nga një organizëm i akredituar dhe se objekti i veprimtarisë së kësaj certificate është i njëjtë me objektin e prokurimit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kadra” shpk për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me nr. REF-51263-02-21-2020, me objekt: “Blerje ushqime në lote: Loti III – Objekti “Blerje bukë (thekre dhe integrale)”, me fond limit 4.509.600 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 22.05.2020, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 588/6 Protokoll; Datë 17.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**